

VENDIM
Nr. 129, datë 13.5.2026

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNNY SIDE ENERGY” SHPK NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 4, pika 1, germa “d”, 5, pika 1, germa “d” dhe 13, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar; si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e Entit Rregullator të Energjisë”, miratuar me vendimin nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 13.5.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 856/15 prot., datë 12.5.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Sunny Side Energy’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Sunny Side Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856 prot., datë 9.3.2026, ka paraqitur kërkesën e saj për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 83, datë 19.3.2026, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 20.3.2026 dhe 21.3.2023) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 30.3.2026), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- ERE, me shkresën nr. 856/4 prot., datë 25.0.2026 dhe *email*-in nr. 856/5 prot., datë 10.4.2026, ka njoftuar shoqërinë për fillimin e procedurës së licencimit, si dhe i ka bërë me dije informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet në aplikim.

- Me *email*-in e protokolluar në ERE me nr. 856/7 prot., datë 14.4.2026, dhe me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 856/8 prot., datë 15.4.2026, shoqëria ka depozituar dokumentacion/informacion plotësues, nga analizimi i të cilit, rezultoi se nevojitet të plotësohej më tej dokumentacioni i aplikimit.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 113, datë 21.4.2026, vendosi të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes për licencim, për t’i dhënë kohë shoqërisë të depozitojë dokumentacionin e munguar.

- Ky vendim iu njoftua shoqërisë me shkresën nr. 856/10 prot., datë 24.4.2026, së bashku me dokumentacionin që duhej të plotësohej. Duke qenë se kjo shkresë është kthyer mbrapsht nga shërbimi postar, ERE i ka dërguar një kopje të skanuar të saj me *email*-in e datës 29.4.2026.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 826/14 prot., datë 5.5.2026, shoqëria ka depozituar të gjithë dokumentacionin e munguar.

- Nga analizimi i aplikimit, rezulton se ajo ka kryer pagesën e aplikimit dhe ka plotësuar të gjithë dokumentacionin e kërkuar nga “Rregullorja për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Sunny Side Energy” sh.p.k., “OST” sh.a., “OSSH” sh.a. dhe “ALPEX” sh.a., për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti